



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVE-SKUPÇINA MALISHEVO



Kuvendi i Komunës
Nr.02/
Datë: 29.09.2023

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON: 05.10.2023

PRIMLJENO

No. Pr. 02/472

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2, pika d, nenit 14 paragrafi 1, të Ligjit Nr.03/040, për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 14, nenit 21 paragrafi 1 pika 1.3 dhe paragrafi 2, të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.10/03, prill 2019), nenit 25 paragrafi 1.1, 1.2 dhe neni 2, neni 25 par 3 të Rregullores (QRK) nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 5.2, neni 25 par. 25.6, mbështetur edhe në Ligjin, nr.05/L-081 për Energjinë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.24/13 Korrik 2016"), nenit 10 paragrafi 1 pika h, nenit 19 paragrafi 1 shkronja a, nenit 46 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, kërkesën e Kryetarit të Komunës nr.01/1306, datë:29.09.2023,

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 29.09.2023 miraton këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT

NR.02/164, Dt.02.06.2023, PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUJTSHME TË KOMUNËS

1. Miratohet kërkesa nr.01/1306, dt.29.09.2023, e parashtruar nga kryetari i komunës së Malishevës, për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.02/164, dt.02.06.2020, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, për Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Tregut-KOSTT, Sh.a. në Prishtinë, për ndërtimin e nënstacionit NS 220/35/10 (20) kv, si dhe për linjat përcjellëse 220 kv në Malishevë.

2. Bazuar në pikën 1 të këtij Vendimi, pika e përcaktuar sipas nenit 5, të vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/164, dt.02.06.2020, fshihet ndërsa me këtë vendim përcaktohet me sa vijon;

2.1 Prona e paluajtshme e përcaktuar sipas nenit 1 të vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/164, dt.02.06.2020, jepet në shfrytëzim me kompensim dhe atë me qira vjetore në shumën financiare prej 200 €.

2.2. Dispozitat tjera të vendimit nr.02/164, dt.02.06.2020, mbeten në fuqi dhe të pa ndryshuara.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronëso-ro-Juridik.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaci



Vendimi ju dërgohet:

1. MAPL-së,
2. KOSTT-Prishtinë,
3. Drejtorive kompetente,
4. Arkivit të komunës.